



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

RELACION TEKNIK

PER PROJEKTIN E ZBATIMIT

Ndërtim "RRJET UJESJELLESI LAGJE ZALL MINER, BASHKIA KAMËZ"

Punoi:

Ing. Flora Muça
Ing. Hajredin Murgu
Ing. Bardhok Alia

Drejtori i P.K.ZH.T-se
Ing. Erlend Baballeku

MIRATOI
Rakip SULI

K R Y E T A R

OBJEKTI: RRJET UJESJELLESI LAGJE ZALL MNER, BASHKIA KAMEZ

RELACION T E K N I K E

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion _____ leke do te realizoje projektin :rrjet i ri te furnizimit me uje per lagjen Zall Mner

Pika e furnizimit me uje do te jene 2 ,te dyja ne Rrugen Nacionale njera afer pallatit te Sadik Tafes ,tjetra afer magazines se miellit dhe karburant Fafes .

Per zonen eshte marre projekt-ideja e Studimit te fizibilitetit te zones nga KFW-ja

1. Qëllimi

Ky projekt zbatimi konsiston në hartimin e nje projekti me qellim ndertimin e nje rrjeti shperndares ujesjellesi ne zonen e Zall mnerit

2. Vendndodhja

Vendodhja e objektit eshte ne lagjen Zall mner Njësia Administrative Kamez , Bashkia Kamez Sipas planvendosjes se meposhtme :



3. Gjendja e infrastruktures ekzistuese

Zona e cila është objekt i projektit nuk ka një rrjet shpërndares të rregullt ujësjes. Linjat shtrihen në një kuotë $Z=60\text{---}78\text{m}$ gjendet.

Depo e Zall Mnerit është e vendosur në territorin e Institutit Bujqësorë e do të furnizojë me ujë një zonë prej 300 objekte nga 1-10 kate

4. Relievi topografik i zonës

Rilievi topografik i zonës për hartimin e këtij projekti zbatimi është bërë me matje topografike të bëra në terren.

5. Përshkrimi i ndërhyrjeve reabilituese

Sipas Detyres së Projektimit qëllimi i projektit është : - Ndërtimi i një rrjeti shpërndares me qëllim furnizimit me ujë të zonës sipas kërkesës së UKK-sha dhe Bashkisë Kamez

5.1 Llogaritjet Hidraulike Llogaritjet hidraulike me qëllim dimensionim të rrjetit shpërndares të ujësjes janë realizuar duke u nisur nga të dhënat e detyres së projektimit dhe sipas normave të furnizimit me ujë për zonën e Zall Mnerit:

- Numri i familjeve në zonën e Zall Mnerit ≈ 1000
- Norma e furnizimit me ujë për popullsinë $n_1 = 150\text{l}/(\text{ba} \cdot \text{ditë})$
- Koeficienti i pikut $= 2$ –

Oret e furnizimit me ujë = 5

- Jetëgjatësia e veprës $t = 25$ vjet
- Norma e rritjes së popullsisë $r = 2\%$

Llogarisim fillimisht popullsinë aktuale në zonën e Zall Mnerit duke marrë një numër mesatar prej 5 banorësh për familje :

$$N_1 = 1000 \cdot 5 = 500 \text{ banorë}$$

Numri i popullsisë për $t = 25$ vjet :

$$N_2 = N_1 \cdot (1 + r)^t = 500 \cdot (1 + 0.02)^{25} = 8200 \text{ banorë}$$

Vazhdojmë llogaritjet e $Q_{\text{max ditore}}$ për përdoruesit : $Q_{\text{max ditore}} = N_2 \cdot n \cdot 1000 = 8200 \cdot 150 / 1000 = 1230 \text{ m}^3 / \text{ditë}$

Llogarisim prurjen mesatare orare

$$Q_{mes\ orare} \quad Q_{mes\ orare} = Q_{max\ dit} / 5 = 1230/5 = 246\ m^3 / orë$$

$$Prurja\ maksimale\ orare : Q_{max\ orare} = Q_{mes\ orare} \cdot K = 246 \cdot 2 = 492\ m^3 / orë$$

$$Prurja\ llogaritese\ me\ qellim\ dimensionimin\ e\ rrjetit : q_{max\ sek} = Q_{max\ orare} / 3600 = 492 \cdot 1000 / 3600 = \mathbf{136.66\ l/sek}$$

Rrjeti i cili do te realizohet eshte menduar duke shfrytezuar rruget ne dispozicion sipas nje skeme ku verehen skemat e hapura.

Llogaritjet e rrjetit fillojne me percaktimin e prurjes specifike :

$$q_0 = q_{max\ sek} - \sum q_p \sum L = 136.66 / 975 = 0.14\ l\ sek \cdot m$$

$$Prurjet\ rrugore\ do\ te\ llogariten : q_{rrug\ a-b} = q_0 \cdot la-b$$

Per te bere llogaritjet e metejshme te rrjetit (percaktimi i diametrave etj) percaktojme prurjen llogaritese ekuivalente me prurjen rrugore dhe tranzite te cdo segmenti : $q_{llog} = 0.5 \cdot q_{rr} + q_{tranzit}$

Llogaritjet vazhdojne me percaktimin e diametrave fillestrar, duke ruajtur kushtin e shpejtesise ekonomike te ujit ne tubacion :

$$(v_{min} = (0.7 \div 0.9)m/sek \quad v_{max} = (1.34 \div 2.68)m/sek$$

Llogarisim tubacionin magjstral duke ruajtur $v=1m/sek$

Vlerat e rekomanduara të shpejtësisë

Diametri nominal (mm)	Shpejtësia (m/s)	Shkalla e prurjes (l/s)
80	0.8	4
100	0.8	6.3
150	0.85	15
200	0.9	28.3
250	0.95	46.6
300	1	70.7
400	1.1	138
500	1.2	236
600	1.3	368
700	1.4	539
800	1.55	779
900	1.65	1050
1000	1.75	1375
1100	1.9	1806
1200	2	2262

Nga sa me sipër me konceptimi i rrjeti është bërë duke ndërtuar një tubacion **PE Dj355mm** i cili do të lidhet me tubacionin e furnizimit të UKK sh.a e të Bashkisë Kamez.

Lidhja e objekteve 1-2kt do të realizohet me tubacion PE Dj-25, mbi 2kt me tubacion Dj-32mm. Materialet e përdorura do të jenë sipas standarteve të cilesisë për ujë të pijshëm. Lidhjet e objekteve do të sistëmohen në kaseta metalike të galvanizuara, ku tubacioni i furnizimit do të përfundojë me saraçineske.

Të gjitha pusetat e manovrimit do të ndërtohen sipas specifikimeve të projektit.